



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivered	26.05	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Orgj /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMBAK	2655/2021		114	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.365/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.16/2020 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.496/2019 të datës 26.08.2019 dhe A.nr.365/2021 të datës 06.05.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Rifat Burgjeviç", Hyrja 8, Nr. 17, Bregu i Diellit në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Agjencia e Regjistrimit Civil/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 26.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.365/2021 e datës 06.05.2021 e parashtruar nga ankuesi e shqyrtuar sipas Aktgjykimit A.nr.16/2020 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Ndryshim të Aktit të Emërimit të datës 13.06.2018 në pozitën "Zyrtar i Teknologjisë Informative për Përkrahje" në Agjencinë për Regjistrimin Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 25.02.2019 ka parashtruar kërkesë tek Menaxherja e Personelit e Ministrisë së Punëve të Brendshme për pagesën e shtesës prej 200 euro që nga vitit 2013.

Menaxherja e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 10.04.2019 ka dërguar kërkesë për aprovimin e shtesës në pagë për kategoritë e veçanta të profesionale deficitare në fushën e teknologjisë informative tek Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të institucioneve për shtesë në pagë për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike.

Ankuesi më datë 11.05.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Menaxherja e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 16.07.2019 nëpërmjet e-mailit ka kërkuar nga z. _____ që të njoftoj që se deri ku është procedura lidhur me shqyrtimin e dokumentacionit për aprovimin e shtesave në pagë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 01.08.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 38/2019 me të cilin ka hedhë poshtë si të jashtëafatshme ankesën e ankuesit.

Ankuesi, kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 26.08.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3861/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.08.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Brendshme. Më datë 04.09.2019 Ministria e Punëve të Brendshme ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Po ashtu ankuesi me datë 14.11.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5372/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet e njëjta si në ankesën e datës 26.08.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 07.10.2019 dhe 23.12.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së datës 26.08.2019 dhe 14.11.2019 duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 26.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.16/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 23.12.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 14.11.2019.

Meqenëse ankesa e parashtruar nga ankuesi e datës 26.08.2019 dhe ankesa e datës 14.11.2019 kanë objektin e njëjtë dhe baza juridike për vendosje është e njëjtë, me Vendimin Nr.3/2021 të datës 19.05.2021 është vendosur që të bashkohen në një ankesë e cila ka marr numrin A.nr.365/2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, administroje këto prova: Ankesën e datës 26.08.2019 me numër protokolli 3861/2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin



Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.38/2019 të datës 01.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Kërkesën e datës 25.02.2019 të ankuesit; Vendimin me Nr.01/39 i datës 08.10.2009 i Kryeministrit të Kosovës; Shkresën me Nr. 5019 të datës 11.10.2013 të Ministrisë së Administratës Publike; Vendimin e datës 04.06.2014 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin A/02/258/2014 të datës 23.07.2014 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 10.04.2019 nga Menaxherja e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për Ministrinë e Administratës Publike; E-mailin e datës 16.07.2019 nga Menaxherja e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për Ndryshimin e Aktit të Emërimit i datës 13.06.2018 të ankuesit; Listën e pagave për ankuesin gusht 2019 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 04.09.2019 me numër protokolli 4104/2019; Njoftimin e datës 07.10.2019; Ankesën e datës 14.11.2019 me Nr. prot: 5372/2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 23.12.2019 për ankuesin; Aktgjykimin A.nr.16/2020 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesën e datë 19.05.2021 për bashkimin e ankesave; Vendimin me Nr. 3/2021 të datës 19.05.2021 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 19.05.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitive dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjatë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: *1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi



Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverise se Republikës se Kosovës, konstatim ky i dhëne edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverise se Republikës se Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatojë se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofroje Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.365/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

